

Procesverbal

Nga Mbledhja VII (e shtatë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 23.07.2024

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat IV dhe V;
2. Raporti i Auditorit të Jashtëm;
3. Plani i Veprimit të Auditorit të Jashtëm;
4. Rishqyrtimi i Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës 2024-2032;
5. Raporti Financiar i Shpenzimeve Janar-Qershor 2024;
6. Miratimi i Statutit të QKMF-së;
7. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Mirë se keni ardhë në seancën VII të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj e keni pranuar të gjithë. Para se me e qit në votim rendin e ditës, unë dua të dal me një fjalim.

Të dashur bashkatdhetarë,

Ne emër të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ju uroj mirëseardhje në vendlindjen tuaj! Ju dëshiroj pushime të këndshme dhe çaste të paharrueshme me familjarët dhe miqtë! Edhe këtë vit, Komuna e Dragashit ju pret me shumë aktivitete të organizuara, për t' kaluar këto ditë së bashku, duke krijuar kujtime të bukura dhe duke forcuar edhe më tepër lidhjet shoqërore mes nesh. Gjithashtu, dua të ju informoj të gjithë juve që keni ardhur nga Mërgata, nëse në çfarëdo forme pronat ose ekonomitë tuaja familjare janë prekur nga vërshimet që ndodhën muajin e kaluar në disa fshatra të Komunës sonë, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve është duke e bërë vlerësimin në terren. Andaj, ju bëj thirrje që me fotografi dhe dëshmi të tjera të dëmeve që u janë shkaktuar, t'i drejtoheni këtij Komisioni Komunal, i cili do ta bëjë vlerësimin e tyre dhe do ta sjellë Raportin përfundimtar në Kuvendin Komunal për miratim dhe procedim të mëtutjeshëm. Besoj se Qeveria qendrore, e cila është përgjegjëse për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore do t'i marrë parasysh të gjitha kërkesat e qytetarëve tanë dhe do të dalë në krah të tyre. Ju faleminderit!

Atëherë, para se ta qesim rendin e ditës në votim, a do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim?

Me 21 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbaleve nga seancat IV dhe V. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim.

Kush është pro miratimit të procesverbaleve? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër

dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Raporti i Auditorit të Jashtëm. Kush do me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje, i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, kolegë/e asambleistë! Qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Në këtë pikë të rendit të ditës po diskutojmë për një dokument shumë të rëndësishëm, i cili dokument tregon se nëse ka pasur gjatë këtij viti shkelje nga ana e ekzekutivit apo jo, e që është dokument që për mu konsiderohet një dokument profesional, prej njerëzve më të mirë të mundshëm, të gjetjeve, të cilat gjetje konsiderohen të mira apo të këqija, e që janë auditorët e jashtëm. E kam lexue me vëmendje këtë material të cilin na e kanë dërgue ekzekutivi. Dokument të cilin e ka dërgue Auditori i Jashtëm tek ekzekutivi. Nuk do të kyçem të diskutoj shumë thellë për këtë dokument, pasi që edhe fizikisht nuk jam në gjendje shumë të diskutoj. Por, natyrisht që do të mundohem të ndalem në ato pikat të cilat është mirë që t'i paraqesim para qytetarëve. Natyrisht, do të kaloj direkt në faqen e gjashtë dhe gjetjet dhe rekomandimet, të cilat i ka dhënë Auditori i Jashtëm për ekzekutivin. Në këtë pikë shohim se Komuna jonë nuk qëndron edhe keq. Mirëpo, ajo që më shqetësoi mu është që këtë vit kemi edhe një gjetje të re nga ana e auditorëve, që në vitet e kaluara nuk ka qenë. Pra, nga katër gjetje që kanë qenë të vitit të kaluar, në bazë të Auditorit, edhe një është këtë vit, pra në vitin 2023. Do t'i lexoj një nga një këto gjetje dhe rekomandime, të cilat janë dhënë nga auditorët. E, që e para ka të bëjë me vonesat me pagesa, që ka qenë në vitin e kaluar; mungesë e efikasitetit në dhënie me qira të pronave komunale; mangësi në regjistrimin e pasurisë, gjithashtu ka qenë; menaxhim joefikas i llogarive të arkëtueshme; tjetra, e pesta: moskompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Unë besoj kjo gjetje është dashur të jetë edhe në vitin e kaluar, sepse Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon kështu që shumë vite, ndoshta prej mas luftës është njëjtë dhe asnjëherë nuk është kompletuar kjo Njësi, ashtu siç e kërkon edhe Auditori. Prandaj, unë pres që në vitet në vazhdim, apo edhe këtë vit, ky ekzekutiv e ka mundësinë që ta kompletojë këtë Njësi, dhe vitin e ardhshëm të mos jetë më si gjetje, por të jetë e kompletuar dhe Komuna jonë të mbetet ndoshta edhe më dy apo me tri gjetje, të cilat nuk do të mund ndoshta të arrijmë t'i kompletojmë, në bazë të kërkesave të Auditorit të Jashtëm. I nderuar drejtor, në një prononcim tuajin këtu që e ke bo, në një seancë pate thënë që është një prej dokumenteve më të mira apo Raport i Auditorit më i mirë i mundshëm. Unë po besoj që, po të kish qenë Raporti më i mirë i mundshëm, tash do të kishim qenë vetëm me dy gjetje, apo edhe tri. Nuk po besoj që në momentin që ke gjetje të re, të jetë Raporti më i mirë. Absolutisht, unë nuk po mund tash të jap atë mendimin tim për ty, se ti çka ke mendue në atë seancë për këtë Raport, dhe nuk po e di saktë nëse e ke ditë që ke gjetje të re apo jo. Por, një pyetje i nderuar drejtor desha të ta bëj direkt ty. Kemi këtu dy gjetje të viteve të kaluara, dhe statusi që e ka dhënë Auditori i Jashtëm është se nuk ka filluar zbatimi fare. Kat ë bëjë me pasuritë. Dhe tjetra është llogaritë e arkëtueshme. Janë dy gjetje të vitit 2022, që në vitin 2023 – në bazë të Auditorit të

Jashtëm – nuk ka filluar fare zbatimi. E keni parasysh dhe a keni marrë masa të duhura që të fillojë edhe zbatimi i këtyre dy gjetjeve apo jo, deri më tani? Pres përgjigje nga ti. Dhe tjetra që desha ta diskutoj, nëse më lejohet, edhe pse kemi në pikën tjetër të rendit të ditës. Ajo që më ra në sy ishte që, tek rekomandimi i plotësimit të vendeve tek Auditori i Brendshëm, nuk keni dhënë koment fare. A ka mundësi të ma jepni përgjigjen, pse nuk keni dhënë koment fare? Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Fillimisht ju përsënder të gjithëve! Sa i përket Raportit të Auditorit, unë me kënaqësi e them se qëndroj pranë asaj që e kam thënë edhe më herët, para se me ardhë ky Raport. Unë nuk dua shumë, vertëm deshta t’juja lexoj opinionin, apo më mirë me thënë, lexojeni opinionin e Auditorit si opinion i përgjithshëm. Sa i përket plotësimit të Njesisë së Auditimit, kjo është një e gjetur e re, por si rekomandim për qeverinë. Mua më gëzon fakti që është kjo, për arsye se, për shkak të vëllimit të punës së investimit kapitale, të rritjes në vazhdimësi dhe numrit të banorëve, deri më tash Komuna e Dragashit ka funksionue me një Auditor. Dhe tash i është rekomandue Auditorit Kombëtar që t’i lejohet Qeverisë Komunale, për shkak numrit të banorëve dhe vëllimit të punës, që të shtohet numri i auditorëve në Njësitin e Brendshëm të Auditimit në Komunën e Dragashit. Si rrjedhojë, kjo na lejon edhe mundëson krijimin e vendeve të reja të punës. Unë nuk besoj që edhe kryetarët pararendës të cilët kanë qenë, nuk kishin pas dëshirë që t’u rritet numri i vendeve të reja të punës. Mirëpo, vëllimin e punëve të cilin është dashtë ta përmbushin përmes investimeve kapitale dhe buxhetit të shpenzuar, nuk kanë arrit në shkallën që t’u jepet kjo mundësi. Prandaj, Kryetarit Bexhet Xheladini dhe qeverisjes lokale të Komunës së Dragashit, për shkak të angazhimit, të punës së mirë, të shtimit të vëllimit të punëve, të investimeve kapitale, kemi mbërri në pikën ku na lejohet që të kemi edhe auditorë shtesë, për arsye se është bërë auditimi një varg të lëndëve tepër të mëdha dhe ju e dini se duhet të ketë periodikisht deri në katër auditime të brendshme. Dhe, në vazhdimësi janë bërë këto auditime të brendshme, mirëpo nuk ka mundësi të arrijë që t’i auditojë të gjitha lëndët të cilat mund të jenë pjesë e auditimit të brendshëm. Ky si rekomandim, nuk na rekomandon neve, por është rekomandim për Qeverinë që t’i lejohet Komunës së Dragashit dhe kjo është një rezultat i punës së mirë të kësaj qeverisjeje. Sa i përket çështjes së regjistrimit të pasurisë, ne i kemi marrë të gjitha veprimet dhe ky është një rekomandim, kemi hap dy nëndepo. Problemi ka ndodhë se me e-Pasurinë e kemi gjet të njëjtin problem të cilin e ka pas Qeveria dhe njëkohësisht, njëra prej komunave e cila ka pas problem ka qenë edhe Komuna jonë, e cila në vazhdimësi nuk e ka bërë regjistrimin e pasurisë nën 1000 euro, për faktin se nuk ka pranue sistemi e-Pasuria. Tash, me marrëveshjen e re është funksionalizue. Mirëpo, deri më tash nuk është bërë asnjë veprim dhe DKA – ja e DShMS-ja kanë bërë të gjitha regjistrimet, por nuk i kanë plasue në e-Pasuria, në Databazën e Komunës. Për herë të parë janë marrë të gjitha veprimet dhe kemi bërë një regjistrim fizik. Falë Vendimit të juaj, delegatëve, ia kemi arrit që në vitin e parë 2022 ta bëjmë regjistrimin fizik të pasurisë komunale nën 1000 euro dhe deri më tash kemi arrit t’i hapim dy nëndepo. Janë angazhuar

dy nëndepoistë, kanë qenë tre në ushtrime, prej këtyre janë Kerim Latifi, Kaltrina Krasniqi dhe Asim Saiti prej Shëndetësisë. Sa i përket gjetjeve të llogaritë e arkëtueshme, realisht këto janë borxhet. Ju e dini që me Vendim të Kuvendit ne kemi falë 40% të shumës nga totali i borxheve për rezidentët tanë. Për këtë arsye, ne kemi arrit të inkasojmë 167 mijë euro në vlerë më shumë për vitin 2023, pikërisht falë Vendimit të cilin e kemi marrë dhe njëkohësisht kemi bërë edhe faljen e borxheve nga taksat e veprimtarisë. Këto dy veprime janë bërë. Dhe tash këto, edhe me uljen e koeficientit për tatimin në pronë, ne kemi arrit ta shtojmë numrin e njerëzve të cilët paguajnë. A janë mbledhur të gjitha borxhet? Jo! Për arsye se kanë mbet borxhe fictive, për shkak se një numër të borxheve, për shumë vite që nuk është mbledhë, pronarët e të cilëve kanë vdekur, askush nuk i merr përsipër. Ato mbesin si të tilla. Shumë shpejt, në këtë Kuvend do ta paraqesim që Kuvendi të marrë një vendim dhe këto borxhe të cilat kanë mbet si statike dhe në vazhdimësi na paraqiten si borxhe të pagrumbulluara, faktikisht t'u japim një zgjidhje. Ajo do të mbetet në seancat e ardhshme, një vendim në dorën tuaj. Mendoj se pas këtyre sqarimeve, do të ishte mirë, për hir të korrektësisë, veç t'jua lexoj opinionin e Auditorit, i cili thotë kështu: *Opinion i pamodifikuar për Pasqyrat Financiare Vjetore – Ne i kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Sipas Opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.*

Unë besoj se nuk ka vlerësim dhe opinion më të mirë sesa qeky të cilin e ka dhënë Auditori. Prandaj, mendoj se duhet të jemi të kënaqur edhe ne, duhet të jenë të kënaqur edhe delegatët e këtij Kuvendi, se një numër i vendimeve të përbashkëta që i kemi marrë kanë afektue në këto rezultate.

Shpetim Hajredini: Faleminderit për përgjigjen, i nderuar drejtor! Nuk më pëlqeu kjo përgjigjja që ma dha për çështjen e zyrtarëve apo Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Ta thashë në fjalimin tim të mëhershëm, që kjo gjetje është dashtë të jetë edhe në vitet e kaluara. Se, nuk e di sa e ke lexue qetu, po këtë Rregullore unë po ta lexoj tash ty, te gjetjet që ta ka dhënë Auditori. Rregullore për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik, Neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7 milionë euro, duhet të ketë së paku tre auditorë. Pra, 7 milionë i kemi ne qe një kohë të gjatë si Komunë, edhe kemi pas të drejtë. Unë e mbaj në mend mirë që edhe në 2019-tën e ma herët ka pas të drejtë Komuna t'i plotësojë këto vende. Por nuk i ka plotësue, arsyen ata e dinë vetë. Por vetëm deshta ta jap një sqarim para qytetarëve që mos të bie poshtë, se këto sende i di mirë, por thashë se nuk jam në formën e duhur për me hy ma gjatë me diskutue

çështjen e auditimit. Por, kjo ti që e tha më herët për këtë gjetje, nuk qëndron. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Shpetim, unë deshta me qenë modest. Investime kapitale, në shumë vite nuk është realizue norma e fillimit të punëve. Në investime kapitale ke kthime në suficit të vazhdueshme. Unë nuk deshta me hy në atë çështje dhe deshta shumë me qenë modest. Kanë pas të drejtën, kanë mund me e shfrytëzue edhe para 6-7 viteve me e bo këtë, nuk e kanë bo. Tash është momenti kur kemi dashtë me e ngrit si çështje, se unë kam kërkue që Auditorit Kombëtar dhe Qeverisë t'i shkojë si vërejtje, që të na lejohet, të marrim edhe dy auditorë të tjerë. Unë këtë vullnetarisht e kam kërkue. Por, nuk dashta me e thënë, mos të merret subjektive kjo çështje. Unë gjashtë muaj jam marrë me këtë problem, dhe kemi mbërri në këtë pikë, se kemi mundësi, kemi kapacitet edhe kemi nevojë. Për një qeverisje të suksesshme ka nevojë edhe për një auditor tjetër, se sa më shumë lëndë auditohen, qaq më mirë, sa ta kontrollojmë vetveten, rezultatet janë më pozitive. Ne kemi ardhë me një motivacion tjetër, me e rujt derisa të mundemi ta ruajmë dhe këtu është krejt primati që kemi kërkue të shtojmë edhe numrin e auditorëve të brendshëm në Komunën tonë.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar delegatë, mjete të informimit, përfaqësues të OSBE-së! Të pranishëm të tjerë! Para se të kaloj në pikën e rendit të ditës, do ta shfrytëzoj këtë foltore dhe mjetet e informimit që ta shpreh një opinion timin lidhur me bashkatdhetarët tanë, të cilët dua t'i dëshiroj mirëseardhje në vendlindjen e tyre. Ne si Kuvend Komunal kemi bërë të gjitha përpjekjet që ata të ndihen shumë komod në vendlindjen e tyre. Gjithashtu, përmes aktiviteteve të ndryshme kemi bërë që këta bashkatdhetarë të ndihen shumë mirë në këtë ditë pushimi që do t'i kalojnë në Komunën tonë. Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, dua të ju them se Komuna e Dragashit dhe Raporti i Auditorit është një ndër më të mirët, në mesin e pak komunave të Kosovës. Është një Raport ekselent dhe për këtë dua t'i falënderoj të gjithë stafin komunal, por edhe delegatët, të cilët kanë punuar në këtë drejtim, që ne sot ta kemi një raport shumë të mirë dhe, në bazë të të cilit, ne prapë do të jemi fitues të Grantit të ardhshëm të Performancës. Kështu që, edhe një herë, e falënderoj edhe stafin komunal, edhe asambleistët, për një punë të mirë që e kanë bo. Auditori nuk ka gjetje, por ka rekomandime, janë katër, prej tyre është një rekomandim i cili nuk varet nga ne. Është një rekomandim ku kërkohet që të rritet numri i auditorëve në Komunën tonë. Jo që ne nuk kemi dëshirë me e rrit atë, por ne nuk kemi mundësi me e rrit, sepse Qeveria duhet të lejojë kodet dhe vendet e punës për me i rrit këto. Nëse Qeveria e lejon një gjë të tillë, ne sigurisht që menjëherë do të shpallim konkursin për plotësimin e këtyre vendeve të punës, edhe ky rekomandim i Auditorit do të plotësohet. Mirëpo, për këto ne mund të diskutojmë edhe në pikën tjetër të rendit të ditës, ku kemi t'i diskutojmë rekomandimet. Kështu që, për momentin unë po e përfundoj me kaq, sa i përket Raportit të Auditimit. Jam i gatshëm t'iu përgjigjem edhe pyetjeve tjera, të cilat do të vijnë sa i përket këtij Raporti. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro Raportit të Auditorit të Jashtëm? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë këtë pikë. Fillojmë te pika e tretët: Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm.

Shpetim Hajredini: Atëherë edhe një herë. I nderuar drejtor i Financave, respekt, por me dashje apo pa, i qite poshtë m'u duk ata të auditimit. Janë privat apo janë shtetëror s'po e di, ma shumë që janë privat po më doket, ata zotërinjtë edhe ajo farë drejtoresha që e ka nënshkruar këtë Raport. Ti thaje që vetë jau ke rekomandue këtë farë gjetje. Nëse ata nuk janë në gjendje me i gjet shkeljet e ekzekutivit, atëherë për mu ata le të lënë këtë profesion, le të kalojnë në profesion tjetër. Unë nuk dyshoj që ata nuk janë të aftë. Se i kam para edhe raportet tjera, se ata fort mirë nuk i njohin ligjet edhe asnjëherë nuk i kanë dhënë gjetjet të cilat janë dashtë me u krye edhe me u bo. Por, tash ti edhe vetë e potencove, që ti vetë këtë gjetje jau ke rekomandue atyre auditorëve dhe ata e kanë shënue di gjetje. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Rishqyrtimi i Vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës 2024-2032. Kush do me e marrë fjalën për këtë pikë?

Shpetim Hajredini: E nderuar kryesuese, mos gabofsha në seancën e kaluar pata kërkuar diçka nga ti, që në momentin që na kthehet një vendim nga ana e MAPL-së, të na vijë edhe arsyetimi i Ministrisë neve, se për çka na është kthyer ai vendim. Nuk na ka ardhur. Unë jam i bindur që kryetari e ka se pse po na kthehet në rishqyrtim edhe një herë, po ne nuk e kemi si asambleistë. Dhe unë tash e kotë është të dal të flas këtu. Për çka të flas, kur nuk e di se çka ka ndodhë dhe pse është kthye prapë. Na mjaft kemi diskutue në seancën e kaluar, kur e kemi votue këtë vendim, këtë plan zhvillimor. Unë nuk jam kundër, edhe në atë seancë e kam potencue, edhe sot. Unë nuk jam kundër një plani, një dokumenti i cili është shumë i rëndësishëm për Komunën. Por, është shumë e arsyeshme, por besoj që është edhe e moralshme, që ky dokument të na dërgohet edhe neve gjithmonë. E kam thënë, financiarisht nuk besoj që ju çon peshë Administratës që të na dërgohet një fletë A4 e cila na kthehet nga ana e ministrive përkatëse. Prandaj, kërkoj nga ju e nderuar kryesuese dhe ekzekutiv, që së paku vendimet e ardhshme të cilat na kthehen, arsyetimi i Ministrisë të na dërgohet edhe neve në material. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Atëherë, pasi m'u drejtua mu Shpetim Hajredini, edhe mu nuk m'u kthye vendimi. As mu, veç kryetarit të Komunës iu ka dërgue ky vendim. Unë atëherë kam reague, me e ditë arsyen pse nuk më është kthyer dhe hala nuk më kanë dhënë përgjigje. Kështu që, të jesh i sigurt që edhe unë nuk e kam pas atë vendim. Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro pikës së katërt? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe 7 abstenime, e miratojmë edhe pikën e katërt. Fillojmë te pika e pestë: Raporti Financiar i Shpenzimeve Janar-Qershor 2024.

Shpetim Hajredini: Kjo çka apo ndodh këtu, në këtë Asamble Komunale, besomni, nuk e di a ndodh najkund, në ndonjë Kuvend Komunal të Kosovës. A ka mundësi ndonjëri prej kolegëve asambleistë qetu, pozitë-opozitë, me dalë me më tregue mu çka jemi duke votue tash? Çka kena votue para dy seancave, kur e kemi pas këtë dokument, çka po votojmë sot, çfarë ndryshimi. Ju lutem, le të dalë dikush këtu, prej asambleistëve, le të ma tregojë mu se çka votuam tash. A jemi na këtu figurë, ngre dorën, ule, ngre dorën e ule, edhe u krye puna. Vetë, ekzekutivi i di këto gjëra, ne nuk marrim vesh send në këto punë. Ne duhet me dhënë llogari para qytetarëve se çka po votojmë. Nuk është në rregull, i keni ju votat, okej, po i votoni, po nuk është në rregull. Edhe nuk jemi duke kërkue diçka të madhe, diçka absurde, jemi duke kërkue vetëm atë që na takon neve. Ligjërisht na takon. Duhet të na sillni në seancat e ardhshme të gjitha arsyetimet të cilat na i dërgon Ministria dhe na i kthen prapë vendimet. Me vendimin, me rishqyrtim, na dërgoni edhe arsyetimin se pse është kthye ajo.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, te Raporti i Shpenzimeve për Janar – Qershor 2024, siç e kam vërejt, te disa shpenzime, te pjesa e pagave dhe e shtesave, te shtesat e veçanta për të zgjedhurit – ia kam bo drejtorit pyetjen edhe herën e kaluar, po nuk ka dhënë sqarim, se në vitin 2022 e 2023 nuk ka pas këso lloji – në vitin 2024 i ka 25 mijë euro. Te kujdestaritet jashtë punës – drejtor, edhe te Raporti tremujor ta kam bo pyetjen, po nuk ke dhënë asnjë shpjegim – 105 mijë euro janë. Kujdestari, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit. Është mirë me dalë me e shpjegue, ne s’e di sa mjekë, nja 20 mjekë mundemi me i pas, po me i pague 105 mijë euro për gjashtë muaj, po më doket një shumë shumë e madhe është qekjo që jeni t’u e pague. Vendimet gjyqësore veç janë duke u rrit vit pas viti. Vjet 188 mijë, sivjet 202 mijë i ke. Qekjo taksa tranzitore, ne mujm me ditë çka është, po qytetarët nuk mujn me ditë, që ti ke pague 3255 euro. Është mirë me dalë për qytetarët me e shpjegue këtë se çka është. Shpenzim për informim publik, 5 mijë euro. Për çdo vje i ke shpenzimet për informim publik në rritje. Plus reklamat dhe konkurset. Në faqe 5 i ke. Po dalim te shpenzimet e rrymës. Unë nuk e di që rryma u rrit, se shpenzimet e tremujorshit ke thënë kanë mbet borxh të dhjetorit, e i kemi pague në janar. Po ty gjithmonë po të rriten, shpenzime të rrymës i ke 10 mijë euro. Plus shpenzimet e mbeturinave, nga 25 mijë në 42 mijë. 17 mijë euro i ke në rritje në gjashtëmujorin e parë. Plus shpenzimet e telefonisë fikse. Unë s’e di çfarë telefoni fikse jeni t’u e përdorë si Komunë – 1800 euro. Po dal te faqja 7, tek fondet, subvencionet për entitete jopublike. Te qeto subvencionet qetu që i keni dhënë, po e marrë shembull te OJQ “Kroi i Macës”, ShKA “Bresana” dhe qeto, unë nuk e di, ju jeni duke iu dhënë OJQ-ve pare për këto, a jeni duke i marrë si ekzekutiv meritat e juaja, që e shkruni nën patronatin e Kryetarit, ose e Komunës, ose ku e di kujt. Kur të ia jep një OJQ-së për me e krye – sikur qysh është Ymer Prizreni, ose nesër që ka me fillue në Bresanë – unë nuk e di qysh merret, edhe plus kryesuesja n aka çue email neve, jeni të ftuar prej kryetarit. A në fakt OJQ-të po përfitojnë këtu, po i marrin këtë tenderat, a po i merr meritat qeverisja. Nën patronatin e Kryetarit, ose të drejtorit, ose

të dikujt. Këtë unë nuk po mundi me e kuptue, qysh mundesh me ia dhënë një OJQ-së. Atëherë, këtu mu po më doket që është duke u bo ndonjë dallavere qetu, me qeto pare. Se nuk është e mundshme, unë s'e di pse vijnë, në email na vjen prej kryesueses një email që janë të ftuar prej kryetarit, nesër që ka me u mbajt, ose që ka me u mbajt në Zgatar Ymer Prizreni edhe këto. Ose, kur të ia jep një OJQ-së, është mirë që me na çue ftesat prej OJQ-së për qeto manifestimet të cilat mbahen në Komunën tonë. Tek shpenzimet e investimeve kapitale, objektet arsimore 27 mijë euro. Drejtor, është mirë me dalë me i shpjegue ku janë shpenzue këto 27 mijë euro, në cilën pjesë. Ndërtimin e rrugëve, kanalizimi, edhe qekjo fusha sportive – 39 mijë euro. Faqe 8 jemi. Pajisjet tjera, që i ke me kod 31690 – 11 mijë euro. Edhe shpronësimin e tokave, ku u bo qeky shpronësimi i tokave, kurse – po dal te faqe 9 – veç po shkrun toka – 2916 euro. Ku është ky shpronësim i tokave, qytetarët duhet me e ditë ku e ke bo këtë shpronësimin e tokave. Rregullimin e stadionit në fshatin Zaplluxhe, unë nuk po e di, qeky rregullimi i stadionit u bo në vitin 2023. Ose jeni duke i bërë me qëllim, që po i qitni tenderat, projekte dyvjeçare, qeto part kah po jesis, 2000, 3000, 5000, 7000, mu po më doken se qeto pare jini duke i bo sa për reklama të Facebook-it, nëse jeni duke i pague postimet në Facebook. Nashta 2 mijë euro, 3 mijë euro ju kushtojnë qeto. Se s'po ma merr mendja që mundin me ju kushtue diçka tjetër. Domethënë, i keni qit 4888 euro rregullimi i stadionit. Unë nuk e kam asnjë punë që e keni bo në stadionin e fshatit Zaplluxhe, te shkolla. Ndërtimi i dyshemesë dhe blerja e pajisjeve në shkollën “28 Nëntori” në Bresanë - 11,675 euro. Hala asnjë investim nuk u bo në shkollë të Bresanës këtë vit, sidomos pajisjet brenda. Hiç ma larg se para dy ditëve kam qenë brenda, asnjë pajisje për sivjet nuk është e investuar këtu. Unë nuk e di qysh i keni bo këto pagesa. Nashta me letra ju mundeni me i mbulue, po investim qaty unë nuk kam parë asnjë investim në Bresanë. Përmbledhja e shpenzimeve, periudha Janar – Qershor, te faqja e 9-të prapë, po dal te Shërbimet Komunale. Drejtor, a mundesh me i shpjegue cilat janë shërbimet komunale që vit pas viti janë duke t'u rrit, ne 2022-tën 65 mijë, në 2023 82 mijë, në 2024-tën 107 mijë euro. Është mirë me dalë me i shpjegue cilat janë këto shërbime komunale. Edhe te faqe 10 – drejtor, nëse ka mundësi – licenca për regjistrimin e bizneseve, asnjë vit nuk ka regjistrim. 18 mijë euro janë licenca. Ku i keni marrë këto pare, sa biznese janë çelë, që i keni bo 18 mijë euro. Unë e di që paguhet veç taksa e licencës. Mos gabofsha, se nuk e di me shumë sa është, 10-15 euro mos është, për regjistrimin e kësaj licencës. Po nuk munden me qenë 18,351 euro. Kryetar, nuk mundi me qenë i padijshëm, se goxha gjatë, shumë mirë i di. Për ekonomi e për matematikë s'mundish me ma kalue, nashta për shëndetësi mundish me ma kalue. Mundish me dalë me fol, del jep shpjegime, kur të dalish me folë këtu. Del e shpjego, çka ke regjistruë 18 mijë euro licenca, taksë të licencës për biznese. Nëse ke rritje të bizneseve në Komunë, hallall të koftë. Unë nuk po e shoh që ka rritje. Është mirë për qytetarët, 18 mijë euro me dalë me i shpjegue për çka janë qeto. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Po nisem prej të fundit, Driton. Shumë e thjeshtë është, është marrë licenca për betonierka edhe prodhim, edhe kanë pas borxhe, janë pague borxhet edhe janë detyrue me i krye borxhet për me i marrë licencat. Shumë e thjeshtë është, mos e diskuto këtë punë. Shko këtu, janë licencat, firmat janë duke funksionue, nashta nuk kas ditëve tjera nevojë ato firmat me operue këtu, edhe kanë operue pa licenca. Por tash kanë marrë të gjitha licenca, se i është kërkue prej Qeverisë, kanë pas edhe borxhe të vjetra, janë detyrue, për me i marrë licencat, i kanë bërë pagesat, është rrit numri i pagesave, edhe shumë e thjeshtë është kjo, s' do ku me ditë çfarë matematike. Te shpenzimet komunale, prej 107 mijëve kanë me u bo 400 mijë. Është duke u punue, Driton. Ka me hy ndriçimi i rrugës së Stadiumit, po hyjnë ndriçimet e fshatrave, janë shpenzime komunale. Është uji, kemi marrëveshjen e pastrimit. Kemi disa shërbime që jemi duke i kryer dhe nuk kanë qenë të kontraktume, janë duke u kontraktuar tash. Dhe në momentin kur kontraktohen, normalisht që rriten shpenzimet. Sivjet – ti KAB'in e ke pas – kemi kërkue 400 mijë euro, për arsye se e kemi një numër të madh të fshatrave të planifikum që do t'ua paguajmë rrymën. A jemi duke e bërë elektrifikimin, a jeni duke lyp si delegatë rregullisht elektrifikimin, a jeni duke lyp ju si fshatar me i shti krejt në sistem pagesat. Në qoftë se nuk i ndajmë paret, qysh mundim bre Driton me bo pagesa. Shumë e thjeshtë është kjo, s' e i pse po mundohesh me e politizue pa nevojë. Mirë, që po foli për qytetarët, që po ju them qytetarë se kur rriten investimet kapitale, kanë efektin që shtohen shpenzimet. Këto shpenzime janë si shpenzime komunale, që me vendim të kryetarit, me premtim të kryetarit dhe me kërkesë të delegatëve, janë parapa që Komuna t'i mbulojë këto shpenzime dhe janë të parashikuara në KAB 2025-2027. Gjatë vitit 2025, shpenzimet komunale prej 200 mijë, do të rriten në 400 mijë. Është si rrjedhojë e investimeve kapitale. Te disa projekte, kemi projekte dyvjeçare, kemi kompani që projektin dyvjeçar të cilin e merr, e realizon brenda një viti, sepse e merr shumën më të madhe të parave, dhe pjesën tjetër ne e bëjmë pagesën vitin tjetër. Ka mundësi që i ka krye punimet më herët dhe e merr pjesën tjetër. Një rast të tillë, po të tregoj, nxemja në fshatin Kosavë. Është krye brenda vitit të parë dhe i ka marrë një shumë të vogël të parave vitin e dytë. Nuk do të thotë se nuk është realizue ky projekt. Këto projektet janë duke u audituar, Driton. Nuk kanë nevojë shumë për politikë dhe nuk kanë nevojë me shkaktue te qytetarët hamendje. Sa i përket shpronësismit të tokave, kjo ka ndodhë herën e fundit në parkun që është duke u ndërtue në Bresanë. Dhe qajo tokë është shpronësuar që është duke u ndërtue parku. Do të kemi edhe rritje te ky pozicion, sepse duhet ta shpronësojmë edhe shkollën e Zgatarit, e kemi si marrëveshje, edhe për atë do ta bëjmë planin për me e bo pagesën e shpronësimeve. Sepse janë obligime të cilat detyrimisht Qeveria duhet t'i marrë. Sa i përket OJQ-ve, dihen që organizohen nën patronatin e kryetarit dhe qeverisë lokale. Çështja është se metodologjia e cila është dhënë më përpara, kur drejtorati ka organizue vetë dhe i ka marrë e i ka krye shpenzimet, ka kalue ajo formë. Tash shkon në këtë formë, përmes subvencionit dhe përmes thirrjeve publike. Këtë metodë Auditori e konsideron si të ligjshme dhe si të drejtë. Është një mënyrë

më e mirë e mundshme organizimi që është duke u bërë këtyre viteve. Këto kanë ndodhë edhe në 2021-tën, edhe e ka bo edhe qeverisja jote. Po nuk e di pse tash po krijojsh hamendje. Unë jam për me bo politikë, por politika duhet me e pas një bazë të qëndrueshme, jo veç me shkaktue huti edhe me u mundue me dhënë një opinion sa për sy e faqe. Prandaj, në një vend ku punohet edhe rriten. Sa i përket shpenzimeve të publikimit të mediave, jemi pjesëmarrës të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit. Shpenzimet e katër bizneseve private i kemi mbulue Komuna. Gjithashtu, kemi bërë shtypjen e broshurave dhe librit për ofertën turistike të Komunës së Dragashit. Kemi marrë pjesë edhe vetë si Komunë në panair, kemi bërë shpërndarjen e broshurave, kemi bërë shpërndarjen e ofertave turistike. Dhe janë pjesë e këtij shpenzimi. E kemi sqarue edhe tremujorin e parë, edhe tash po jua sqaroj. Kështu që, unë mendoj se është një Raport gjashtëmujor i cili ka ndodhë dhe ky as nuk ndryshohet, as nuk plotësohet. Po e diskutojmë, janë pjesë e rritjes edhe të çmimeve. Ky buxhet, falë Zotit, mirë është që rritet, dhe ne duhet të jemi të kënaqur të gjithë bashkërisht që po rritet edhe konsumi, edhe shpenzimet. Shkojnë në favor të qytetarëve, të bizneseve dhe e rritin fuqinë blerëse në Komunën e Dragashit, që në ekonomi konsiderohet si një zhvillim ekonomik. Prandaj, këtu mendoj se jemi shumë të qartë, edhe nuk kemi nevojë shumë me e diskutue këtë çështje, Unë besoj që shumë më mirë është që të përgatitnu në Raportin përfundimtar vjetor. Atëherë të ulemi e t'i diskutojmë, pozicion për pozicion, raportin e shpenzimeve. Do të isha shumë më i kënaqur që atëherë t'i kushtoni sa më shumë rëndësi dhe ne bashkërisht ta diskutojmë se a kemi shkue rrugës së drejtë apo jo.

Nexhat Selaj: Përshëndetje kryesuese, kryetar, përshëndetje kolegë asambleistë! Një pyetje, drejtor i Financave. Me besueshmëri të plotë e kam përcjellë komplet, edhe po ju përcjelli në këtë debatin këtu çfarë po zhvillohet. E kam lyp edhe në seancën që shkoi, nuk më është dhënë një përgjigje, prapë po kërkoj një përgjigje. Tek Lista e projekteve kapitale të realizuara në periudhën Janar – Qershor 2024, unë deshta me të pyet tek projekti i aneksit në ShML “ Ruzhdi Berisha”, që ishte i planifikuar të përfundojë, ishte projekt dyvjeçar 2023-2024. Tek Lista e shpenzimeve janar – qershor nuk po shoh se kemi shpenzime. A do të kemi shpenzime edhe realizim të projektit në pjesën e dytë. A do të përfundojë ky projekt apo jo? Nëse nuk fillon gjatë kësaj kohës së pushimeve – që gati pushimet veç u kryen – mendimi im personal është që të mos vazhdojë gjatë shtatorit e tetorit, se po kemi pengesa në mirëmbajtjen e mësimit të rregullt. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdir: Përshëndetje të gjithëve, keni 102,035,96 cent shpenzime udhëtimi në vend për 6 muaj, kodi 13130, vitin e kaluar 2023 keni arritur të shpenzoni 24,559,68 cent në 6 muajt e parë, ndërsa në vitin 2022 ishte pak më pak se 20,000 euro. Që do të thotë se shpenzimet tuaja të udhëtimit të brendshëm janë rritur me 415% këtë vit. Pse? Meqë keni qenë në pushtet, shihet se kostot e udhëtimit tuaj në vend janë vazhdimisht në rritje. Ku keni udhëtuar shumë? Ju keni kodin 13340 shërbime speciale, saktësisht 95.000 euro. 2023-0, 2022-0, pse kemi 95,000 euro këtë vit. Gjëja e tretë kodi 13720

naftë për ngrohje qendrore janë shpenzuar 18955,59 cent, në 2023 keni shpenzuar 2987,55 shpenzimet tuaja janë rritur me 634%. Duke qenë se dimri nuk ishte më i ashpër këtë vit, çfarë ngrohëm që kostot e ngrohjes na u rritën me 6345%. Jam ankuar disa herë se stafi shëndetësor po ngrinte, dhe drejtori i shëndetësisë më pas mburrej se është kursyer një shumë e madhe parash për ngrohje për faktin se personeli mjekësor ngrohej me ngrohës. Gjëja e katërt, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve. 19,459 euro një rritje prej 409%, ku i kemi thyer të gjitha ato automjete. Vitin e kaluar kemi pasur 4757 euro për gjashtë muajt e parë. Po kerkoj nje te vecante qe te me tregoje se cilat automjete keni riparuar. Koleg Haradinaj, instalimi i çdo diktature fillon kur nuk i kushtohet rëndësi kuvendit. Kur qeveria shpërfill ekzistencën dhe qëllimin e kuvendit, atëherë fillon diktatura. Pikërisht këtë po na bëjnë. Edhe ne nga opozita jemi pak fajtorë sepse i kemi lejuar ta bëjnë këtë.

Driton Ademi: Drejtor, po dal te pika, te toka që thajë shpronësim në Bresanë. Veç po ta lexoj në Bresanë çka ke miratue në buxhet, në vitin 2023 për 2024. Kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Luftëtarët e Lirisë”, Rruga e Zgatarit dhe Rruga e Imamajve, dhe ndërtimi i Parkut në qendër të fshatit Bresanë. Qeto e ke miratue në vitin 2023 për buxhetin e 2024-tës. Në KAB, drejtor, kubëzimi i rrugëve në Rrugën “Luftëtarët e Lirisë”, Rruga e Zgatarit dhe Rruga e Imamajve, ndërtimi i murit mbrojtës në Rrugën “Danaj”, dhe rregullimi i Parkut në qendër të fshatit Bresanë – shpronësim. E ke planifikue në KAB, drejtor, qeto. Ku e gjete këtë tokën, me çfarë kod buxhetor e ke pague tokën në Bresanë, 2 mijë e diçka euro. Mos del me manipulue, qekjo për mu është manipulim. Se në vitin 2023, kur e ke miratue buxhetin, nuk i ke pas qeto pare, nuk ke pas shpronësim. E ke planifikue në KAB 2025-2027. Ti neve mundesh me na thënë për letra, po unë ta gjeta miratimin e buxhetit në 2023 për 2024-tën, nuk i kie. Edhe pyetjen tjetër, drejtor, unë ta bona pyetjen licencë për regjistrimin e bizneseve. Këtu po thotë shpenzime, prej të hyrave, më fal! Prej cilave të hyra janë? Ti po thuesh veç taksë që janë duke pague, prej cilave taksa janë këto licenca? Kush përfshihen te këto licenca? Bizneset apo kush përfshihen, qeshtu është pyetja. Bizneset e di, po a edhe tjerat? Faleminderit!

Qamil Kolloni: Sa i përket pyetjes së parë të delegatit Nexhat Selaj, po thotë e kemi në realizim të projektit të aneksit të Shkollës së Mesme “Ruzhdi Berisha”. I nderuar delegat, mjetet janë ndarë dhe është kontraktuar, operatori ekonomik i ka marrë punimet. Se a do të kryhet, mbetet të bisedohet me menaxherin dhe deri ku ka mbet mes operatorit dhe menaxherit. Kemi kërkue edhe prej drejtorit të shkollës, kur kemi qenë këtu në debat vetëm për shkollat – kemi kërkue që të na jepet një raport edhe të gjejmë mundësinë, bashkë me drejtorin e Arsimit, si të dalim nga kjo situatë, dhe të shtojmë edhe mjete shtesë për me e rregullue këtë problem. Por, më mirë për këtë çështje, se deri ku kanë mbri punimet, do të ishte mirë që të japë përgjigje menaxheri i këtij projekti. Sa i përket pyetjes së delegatit Nedžmidin Sejdlar, për udhëtimet në vend. I nderuar delegat, me rritjen e shpenzimeve për udhëtime zyrtare brenda vendit, janë të përfshira edhe transporti i nxënësve. Besoj që ju e dini që ka fillue

transporti dhe është duke u kryer transporti i nxënësve. Sa i përket shpenzimeve të veçanta - 95 mijë euro, në këto shpenzime ka ndikuar kontrolli teknik i automjeteve. Matja e kanalizimit në QKMF, kontrata për shërbime të veçanta dhe ambienti me "Human Care", për pastrimin e qytetit dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, parqeve me kanalizime. Hapja e kanalizimit dhe sanimi i gjendjes në fshatrat Kuk, Kapre, Kosavë, Bellobrad, Zaplluxhe dhe Dragash. Kurse, sa i përket naftë për ngrohje qendrore, ju e dini që e kemi furnizimin edhe varësisht qysh na vijnë faturat, qashtu edhe i bëjmë pagesat. Ka mundësi, në një periudhë kohore të vitit mos me na ardhë fatura edhe nuk bëjmë ndonjë pagesë, kur na vijnë faturat sipas marrveshjes të cilën e kemi nënshkruar me kontratën kornizë, atëherë ne e bëjmë edhe pagesën e tyre. Ka periudha kohore që mundim ma pak a ma shumë, ajo vibron. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve: Ju e dini që një kohë nuk kemi pas kontratë dhe për fazën të cilën nuk kemi pas, në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ne e kemi bo edhe riparimin e disa automjeteve të cilat kanë qenë të paservisuar. Për këtë arsye edhe është rrit kjo vlerë. Driton, mendoj sa pak i ke të përzime çështjet, po ti e dish se shpronësimin e kemi bo. Në qoftë se duesh pak më detajisht, mundesh me ardhë në zyrë, me i kqyr faturat drejtpërdrejt, edhe kohën edhe afatin kur i kemi bo. Këtu i kemi pasqyrat përmbledhëse prej Raportit, në qoftë që kërkosh sqarime më detale, nëse duesh edhe t'i bina këtu t'i tregojmë ku i kemi bo pagesat edhe qysh i kemi bo pagesat. Po besoj që nuk është shumë efektive as për ty e as për ne të dalim në atë mënyrë.

Nedžmidin Sejdilar: Pyetjen për kostot e udhëtimit në vend e bëra qëllimisht, sepse ju më dhatë të njëjtën përgjigje vitin e kaluar. Ju thatë se transporti i fëmijëve vendosej në të njëjtën kategori. A do të thotë kjo se tani kemi 450% më shumë studentë ose thjesht kosto. Për shërbimet speciale thatë që keni kontratë me Human Care, kemi 3 vite që i diskutojmë dhe nuk keni dorëzuar asnjë dokument në kuvend, që ne si delegatë të shohim pse i paguajmë dhe çfarë shërbimesh ofrojnë në komunën tonë. Nëse mund ta përshkruani pak më hollësisht funksionimin e Human Care, ne i kemi dhënë shuma të mëdha parash dhe nuk kanë ndonjë rekomandim pozitiv në internet. Naftë për nxemje qendrore thate që paguan kur te vijnë faturat dhe sipas logjikes faturat vijnë me harxhimin e vajit. Faturat nuk mund të mbërrijnë para se të konsumohet vaji. Ju lutem shpjegoni më mirë. Cilat automjete janë mirëmbajtur, çfarë është zëvendësuar dhe pse kostot janë rritur me 409%, nga 4000 në 19000 euro. Çfarë keni bërë, çfarë keni shërbyer? A përfshihet këtu vetura e diskutueshme e ambulancës?

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe një herë! Drejtor, aspak nuk isha i kënaqur me përgjigjen që ma ktheve. Vetëm m'u drejtove se paratë i kemi alokuar. Kur do të përfundojë, çka ka në të, nuk sqarove asgjë. Me konkretisht, viti shkollor kalendarik i mësimin 2024/25 po na fillon në shtator. Në aneksin i cili ka qenë të përfundojë në vitin 2024, ka qenë projekt dyvjeçar, 2023-2024. Menaxher s'ka nevojë me të pru, me kqyr deri ku kanë arritur, e ke drejtorin e Arsimit këtu. Meqenëse e di se ai s'un i lidh dy fjalë me dalë këtu me prezantue dhe me folë. Eja shkojmë bashkë, tash si ta kryejmë seancën, e shohim

bashkë se në çfarë gjendje e ke aneksin. I ke vetëm katër shtylla – mos gabofsha – pesë. Vetëm që është shkatërrue edhe vetëm që ka humb pamja e asaj shkolle, jo që është meremetuar ose rregullue diçka. Ju keni pasur në afatin në 2024-tën të përfundojë. Unë të bëra një pyetje, a do të përfundojë tash, gjatë kësaj periudhe – korrikut edhe gushtit – edhe nëse jo, mundësisht mos vazhdoni, bartni mjetet që të vazhdojë në vitin 2025, se përndryshe shkaktohen probleme në mbarëvajtjen e mësimin. Në sqarove asgjë, as për mu, as për kolegët 60 profesorë, as për 500 nxënës, nuk dhaje kurrfarë përgjigje. Nëse nuk është ashtu, bashkë shkojmë, qe edhe kryetari, besoj që është i vullnetit të punës, shkojmë në vendin e ngjarjes edhe e shohim se në çfarë gjendje të mjerueshme e ke Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash.

Shpetim Hajredini: Përhëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar drejtor i Financave, gjatë leximit të këtij Raporti kam vërejt disa lëshime, po besoj që kanë qenë më shumë teknike. Nuk po besoj që janë lëshime që i takojnë profesionit. Tek faqja e parë, informacionet mbi buxhetin kur ke dhënë, nuk ke ndryshuar. Buxheti për vitin 2023 vazhdon të figurojë edhe në këtë Raport të vitit 2024. Duhet të përmirësohet dhe të jetë 2024. 2024-shin e kemi 12 milionë e 110 mijë, 2023-shin 10 milionë e 871 mijë. Këtë e dish mirë, mirpëo besoj që është teknike, s’e ke përmirësue. Por, kur e lexon me vëmendje, edhe e kupton problemin. Vazhdojmë në faqen 2, tabela nr.1, aty ku në këtë tabelë ke bërë krahasimin e burimit të financimit të buxhetit. Është mirë të më japësh sqarim, po shpresoj që unë të jam gabim – por nuk besoj që jam gabim. Në Total, totali i buxhetit, për vitin 2027 e ke 12,607,061.76, është në rregull. Kur bëjmë krahasimin me vitin 2023, shohim se këtu është bërë një lëshim i vogël. Në 2023, në këtë tabelë të Raportit të vitit 2024, e ke 11,210,732.14. Kur në fakt, në Raportin e vitit të kaluar, në TM2 të vitit të kaluar, e kemi 11,213,732.02. Pra, këtu është një gabim dhe këtë dola të ta shpjegoj apo që të mos e bartish të njëjtin gabim edhe në TM3, sepse gabimi i krahasimit, njëjtë, në këtë tabelë me tabelën e vitit të kaluar, të Raportit të njëjtë, edhe 2022-shi u bë me gabim, e ke bo një lëshim. Prandaj është mirë që këto dy lëshime të mos i bartish në Raportin që na vjen pas tre muajve, në TM3. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë! Shumicën e sqarimeve sa u përket pyetjeve të delegatëve, i dha drejtori i Buxhetit. Unë vetëm dua të bëj disa plotësime. Sa i përket aneksit të Shkollës së Mesme, nuk ka qenë projekt dyvjeçar, por njëvjeçar dhe ka qenë projekt i vitit 2023. Për fat të keq ky projekt nuk ka përfundue, edhe pse mjetet kanë qenë të sigururara, është shpallë tenderi me kohë, është zgjedhur punëkryesi. Mirëpo, punëkryesi ka qenë jo i përgjegjshëm dhe nuk ka mund me i krye punët deri në fund të vitit, dhe një pjesë e atyre mjeteve – që nuk janë shpenzuar sepse nuk ka përfundue projekti – janë kthyer prapë, ose i ka marrë përmbaruesi. Nuk ka qenë projekt dyvjeçar dhe për vitin 2024 nuk ka pas të planifikume mjete për me vazhdue. Arsyeja është se ne kemi menduar se ky projekt do të përfundojë në vitin 2023. Në seancën e kaluar është bërë e njëjta pyetje dhe janë dhënë sqarimet. Është

thënë se drejtori i Gjinnazit ka bërë kërkesë në DKA, jo vetëm për këtë projekt por edhe për projekte të tjera. Unë jam interesuar në DKA, nga të dhënat që i kam marrë, drejtori i Gjinnazit asnjë kërkesë nuk e ka bo. Bile, as kërkesën për Shkollën e Mesme dhe aneksin. Nëse kjo nuk është e vërtetë, mund të shkoni ta vërtetoni, nuk ka bo kërkesë Gjinnazi. Edhe këtu u kërkua që, masi nuk është bërë deri më tani, po kërkohet nga ju që mos të fillojnë punimet kur të fillojë viti shkollor. Është një kërkesë reale, për arsye se nëse tash shpallet tenderi, para shtatorit nuk mund të fillojnë punimet, andaj është mirë që ky projekt të mos fillojë edhe këtë vit të realizohet. Sa i përket shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit, 90% e këtij pozicioni janë shpenzimet nga udhëtimi i nxënësve, kurse 10% janë shpenzime tjera. U tha një e dhënë se është rrit mbi 400% shpenzimi për këtë pozicion. Është fakt, mirëpo ju e dini që në muajin e gjashtë përfundon viti shkollor dhe këtu janë bërë pagesat e pesë muajve të udhëtimit të nxënësve, kështu që kjo është shumë reale. Nuk ka këtu kurrfarë rritje, por është bo përfundimi i pagesës dhe përfundimi i kontratës. Tani Komuna ka shpallë kontratën tjetër për transportin e nxënësve dhe për këtë janë sigurue edhe mjetet. Nuk kemi rritje të shpenzimeve, por kemi përfundim të kontratës dhe pagesës për këtë pozicion, te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit. Sa i përket shpenzimeve të veçanta, ju e dini që në këtë pozicion hyjnë edhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve, pastaj pagesa e mjekëve specialistë. Sa i përket naftës për ngrohje, ju e dini që kjo blihet zakonisht në muajin nëntor dhe dhjetor. Në bazë të një vendimi të qeverisë, nafta e cila është blerë në nëntor dhe dhjetor, nuk mund të paguhet në dhjetor, për arsye të berzës dhe çmimeve. Kështu që, naftën që e kemi blerë në nëntor dhe dhjetor, kemi qenë të detyruar ta paguajmë pas Vitit të Ri, sepse çmimi i berzës nuk ka qenë i gatshëm dhe kompania e cila e ka furnizue Komunën me naftë, nuk na ka pru faturën për pagesë, për shkak se ka qenë vendim i Qeverisë që nafta të paguhet - për çdo muaj berza e çmimit të naftës ndryshon – për këtë qëllim e kemi një rritje të pagesës, e jo të shpenzimit të naftës. Bile, do ta shihni ju në fund të vitit, kur do të jepet Raporti përfundimtar, do ta shihni se sigurisht 40% do të ketë më pak shpenzime për ngrohje sesa qeveritë e kaluara që kanë pas. Sa i përket mirëmbajtjes së automjeteve, ju e dini që mbi gjashtë muaj Komuna ka qenë pa kompani mirëmbajtëse të automjeteve, për arsye se i ka kalue kontrata kompanisë ekzistuese, edhe lënda ka qenë dy herë në OSHP dhe pastaj, pas betejës që e kemi fitue, është lidhë kontrata me një kompani e cila ka qenë më e lira, dhe është bërë servisimi dhe mirëmbajtja e të gjitha automjeteve, si të shëndetësisë, si të Komunës, zjarrfikësve etj. Shuma prej 90 mijë euro nuk është shumë e madhe, por është shumë reale, bile është shumë më e vogël sesa në çfarë gjendje kanë qenë automjetet e Komunës sonë, ku gjashtë muaj nuk është bërë as servisimi, e as riparimi i tyre.

Shpronësimi i tokës: Në pozicionin e ndërtimit të parkut në Bresanë ka qenë i paraparë – në vitin 2023 – edhe shpronësimi i ndërtesës së “SharrProdhimit”, ku Komuna e ka bërë shpronësimin, Asambleja e ka votue, Qeveria e ka vlerësue që shpronësimi i asaj toke është diku afër 12-13 mijë euro. AKP-ja na ka thënë që nuk duhet me e pague të gjithën, por duhet me e pague një pjesë të shpronësimit, dhe ne

kemi pague diku 2-3 mijë euro shpronësimin. Dhe është pozicioni i shpronësimit, po ti nuk e ke pa, kështu që kur të del në foltore duhet me pas të dhëna të sakta. Sa i përket automjeteve të ndihmës së shpejtë, u bë shumë zhurmë këtu. Është bërë aq zhurmë, sa që është bërë një propagandë jo e mirë, ka pas edhe shpifje, edhe gënjeshtër për automjetet e ndihmës së shpejtë. Në momentin kur DShMS-ja ka kërkuar nga delegatët që të dalin t'i shikojnë të gjitha automjetet që janë në pronësi të QKMF-së, ta shohin gjendjen e tyre, ta shohin numrin e tyre, ta shohin edhe atë automjetin që po përfolet shumë se nuk ka qenë në gjendje të mirë, atëherë ju delegatë e dini, keni protestue ashpër dhe nuk keni dalë me i pa automjetet. Pse nuk keni dalë? Sepse keni shpif një vit të tërë. Edhe tash, ky refuzim i juaji për ta parë gjendjen e automjeteve është bërë me qëllim, sepse aty do të kishin qenë edhe mjetet e informimit, edhe qytetarët do ta kishin pa që, ajo që keni shpif një vit ka qenë gënjeshtër. Unë ma shumë një herë nuk kam, dhe besoj që kjo pikë ka përfundue, askujt nuk ia kam përmend emrin. Kryesuese, të lutem, zbatoje Rregulloren!

Arijeta Skeraj: Atëherë, ne do ta vazhdojmë këtë pikë, pasi që e pyeta edhe zyrtarin ligjor. Kërkoj falje, kryetar, këtu është për me diskutue, asambleistët kanë të drejtë me bo pyetje, e ju më dhënë përgjigje.

Nexhat Selaj: Faleminderit për korrektësinë, kryesuese! Kryetar, vetë po thuesh se auditimi kur po sjell diçka pozitive, po na falënderojsh të gjithëve. Edhe unë ta pranova shumë atë që thajë bashkërisht ka ardhë që auditimi ka dalë me një performancë shumë të mirë, edhe jam shumë krenar për atë. Edhe kur po është në atë moment që t'i marrësh poenat pozitive, po drejtohesh edhe nga opozita. Shumë në rregull, po më vjen mirë. Në seancën paraprake, kryetar, prapë e kam qit temë diskutimi këtë, më ke thënë do të shikojmë se ku kanë mbetur punimet. Në seancën e sotit, drejtori i Drejtoratit po thotë do të shikojmë menaxherin dhe punëkryesin se deri ku kanë arritur punimet, ju thoni se ka dështuar ky projekt. Hala më keq kur drejtoheni, thoni nuk ka qenë projekt dyvjeçar po ka qenë projekt njëvjeçar. Nëse ka qenë projekt njëvjeçar, a e din kur kanë fillue punimet në aneksin e ShML "Ruzhdi Berisha"? Më 10 dhjetor të vitit 2023. Në seancën e fundit të vitit 2023, unë ta kam bo një kërkesë, të kam thënë që në dimër vetëm tek ne fillojnë punimet. Më 10 dhjetor të vitit 2023. Si e ke lejue, në përfundim të asaj kontratës të fillojnë punimet? Unë po çuditem! Tash, nëse ka qenë 2023, në dhjetor të vitit 2023, më 10 dhjetor të vitit 2023 kanë fillue me t'u bo punimet. Me çfarë të drejte, çfarë baze ligjore, po të përfundon ty viti edhe 20 ditë, ju e lini kompaninë me ardhë me punue. Kjo ka qenë vetëm që ju t'i harxhoni paratë, që të thoni kemi shti një pjesë të parave në qarkullim, që të mbulonon, mos të ktheni para mbrapa, a punët nuk janë askund. Sa i përket asaj që thuesh kam kërkuar, në seancën tjetër, kryetar, t'i bie të protokolluara nga Sekretariati të gjitha kërkesat të cilat janë bërë për ShML "Ruzhdi Berisha". Të jesh shumë i sigurt! Po më vjen keq me të thënë, se po duash ta mbrosh drejtorin, edhe kur po dalish këtu po humbish. Nuk po kam qef me të pa në këso pozicion. Gjinnazin e konsiderojmë akademi, do

ta ruajmë akademi bashkërisht dhe duhet të japim mund për atë Gjinnaz. Jo vetëm të dilet në foltore edhe të folet për atë Gjinnaz. Nëse nuk ke diçka, nëse ke diçka t'u vëshë pikë këtyre fjalëve, kam qef të dalësh këtu. Unë kam me fakte, të incizuara, që punimet në aneks kanë fillue më 10 dhjetor të vitit 2023. Ju po thoni ka qenë projekt i vitit 2023, me çfarë rregullore, me çfarë ligji e lejon kompaninë në fund të vitit me fillue. Në seancën paraprake, para kësaj, ta kam bërë kërkesën, e ka pas drejtori, ka thënë do të përfundojë. Po 2023 ka qenë, më 10 dhjetor të ka fillue. Nëse kam gabue teknikisht, më fal! Më 10 dhjetor të vitit 2023 të kanë fillue punimet. Ju thatë se projekti ka qenë i vitit 2023, edhe po e pranojsh tash. Por me çfarë të drejte për 20 ditë vetëm me ardhë me përzie atje, me tollovit punën? Drejtori tha se do të shikojmë me menaxherin ku kanë arritur punimet, ju tash thatë se ka dështue ajo. Ju koordinonu mirë edhe dilni këtu. Unë e kuptoj se çfarë problemi po ju ngjan, se drejtori i DKA-së duhet të dalë këtu dhe të jep këso sqarime. E jo të ju drejtohem unë juve si kryetar, edhe drejtorit të Financave. A për kërkesat, në seancën tjetër – kysmet prej Zotit – t'i bie të gjitha kërkesat të protokolluara nga Sekretariati i shkollës. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë nuk deshta të diskutoj sot, por na detyroi edhe na dhunoi kryetari, me dalë në foltore. Zonja kryesuese, më vjen mirë që nuk lejove të kapet ky Kuvend. Nuk është koha e komunizmit, nuk mund të mirret fjala e lirë e qytetarit, nuk mund të na merret fjala e lirë e delegatëve. Thashë edhe një herë, faleminderit shumë, se nuk është komunizëm. Për këtë foltore edhe për këto gjenerata kanë luftue shumë njerëz, kanë dhënë djerës e gjak, e dije, e shumë sende. Herën tjetër, të mos tentohet me u kap Kuvendi, qysh është tentue edhe qysh po kapet, po mos ta bëjmë ma total, se është për faqe të zezë. Sa për te automjetet e QKMF-së, unë jam punëtor i QKMF-së aty, edhe e di gjendjen e automjeteve shumë mirë. Ju keni pas dëshirë, kryetar, sa për një ditë me z.Behar Brenoli, me mësuesin e juaj, keni pas qef mediat me i pru sa një ditë, ato automjetet me qenë në gjendje të mirë. Ato automjetet duhet me qenë në gjendje të mirë 24 orë, 7 ditë, 365 ditë në vit. S'po due më shumë me diskutue, se unë e di më mirë gjendjen e automjeteve, se unë direkt punoj me kolegen e nderume, znj.Esati.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e qesim në votim pikën e pestë. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, 3 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e gjashtë: miratimi i Statutit të QKMF-së. A do dikush me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, unë vetëm deshta të jap një sqarim. Nuk deshta t'ua marr fjalën delegatëve të cilët nuk kanë diskutue, unë vetëm kërkova nga kryesuesja të zbatohet Rregullorja për ata delegatë të cilët e kanë shfrytëzue të drejtën e tyre, dy diskutime me i pas brenda një pike të rendit të ditës. Kurse ti Artan, ke pas të drejtë me dalë, nuk e kam pas fjalën për ty. Sa i përket pikës së rendit të ditës, për Statutin e QKMF-së, ju e dini që kjo edhe në seancën e kaluar ka qenë si pikë e rendit të ditës dhe ka ngjallë debat. Sidomos Neni 13 i Statutit, edhe siç e dini, Statuti është një statut i cili është marrë

nga Ministria. Vetëm janë bërë disa ndryshime të vogla dhe është prurë në Asamble për miratim. Para se Asambleja të debatojë për Statutin, unë propozoj disa ndryshime – plotësime të Nenit 13. Në këtë Nen dëshiroj të shtoj që, pasi që QKMF-ja jonë ka mbi 100 të punësuar, dhe në bazë të Rregullores, QKMF-ja ka të drejtë të ketë edhe zëvendësdrejtor, unë propozoj që në Nenin 13 të Statutit, Pika 4, të futet që QKMF-ja duhet të ketë edhe zëvendësdrejtorin. Pastaj, Pika 4.1 do të shënohet që zëvendësdrejtori e ndihmon drejtorin në kryerjen e punëve të përditshme dhe punon në iniciativën e tij, dhe i zbaton udhëzimet e tij në kohën kur ai nuk është prezent në QKMF, apo është në pushim etj. Dhe, Pika 4.2: zëvendësdrejtori duhet të jetë nga komuniteti joshumicë, nëse drejtori është nga komuniteti shumicë, ose edhe anasjelltas. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve, unë fola për këtë Statut në mbledhjen e fundit. Unë propozova disa amendamente, më vjen mirë që Kryetari lejoi që zgjedhja e zëvendësdrejtorit të përfshihet në nenin 13, duke qenë se ne kemi bazë ligjore dhe kështu është në versionin e unifikuar të Statutit të QKMF-së në Kosovë. Unë do të sugjeroja vetëm që të fusim paragrafin 4 në nenin 4 që Drejtoria e Shëndetësisë të menaxhojë procedurat për zgjedhjen e zëvendësdrejtorit.

Artan Loshaj: Ky Statut ka qenë edhe vitet e kaluara. Është i njëjti, me disa ndryshime. Më vjen mirë, kryetar, që e fute edhe Nenin 13, por keni pas kohë, jo me ardhë në minutat e fundit me i bo këto ndryshime, keni pas kohë edhe më herët. Unë pata qef edhe mësuesin Behar sot me e nije pak për QKMF-në me folë, për Statutin me folë. Po nesje, ti je kryetar, mundesh me e marrë fjalën. Unë shpresoj që ky Statut të mos jetë veç sa për performancën e juaj, mos të jetë sa për sy e faqe, vetëm të votohet edhe të futet në ato fiokat edhe ta merr pluhni. Se, me të vërtetë ka shumë nevojë ky Statut të votohet edhe të miratohet, se ka shumë ngecje në shëndetësinë e Komunës së Dragashit. Nuk po due me ju akuzue juve sot që keni ardhë, këto probleme kanë qenë edhe me pushtetin e PDK-së, ku vij si asambleist i asaj partie. Me të njëjtin drejtor, të famshmin, mësuesin Behar. Thashë edhe njëherë, mu po më vjen mirë dhe do t'i lexoj do nene të cilat do t'i votoj me gjithë qef unë si asambleist, por me siguri edhe GP i PDK-së. Shembull, Nenin 7, Pika 11.1, ku thotë se shërbimet e kujdesit shtëpiak, përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës. Këtu një kohë është dalë në terren, tash një kohë nuk dilet. Kujdesi paliativ si dhe kudesi shtëpiak. Ju e dini shumë mirë se shumica e qytetarëve tanë janë të moshuar edhe të rinjtë e tyre janë në gurbet. Kërkoj nga drejtori edhe nga menaxhmenti që, urgjentisht, pas votimit të këtij, të merren me këto kategori, për arsye se shumë punëtorë të ri që keni marrë, kolegë të mi në QKMF, me siguri i keni marrë për me dalë në terren. I keni edhe makinat për me dalë në terren, për kujdesin paliativ. Punëtorët i keni marrë edhe rrinë nëpër QMF. Këta edhe ne duhet të dalim në terren. Pastaj Neni 9, Pika 1.2.4, Zyra e Prokurimit. Unë qe 25 vite punoj, nuk ka Zyrë të Prokurimit, s'e di a duhet. Në qoftë se duhet, me siguri jeni duke e prot deni vend të lirë dikuj me ia mundësue. Po mirë është, s'është problem. Neni 10, që ka funksionue, po për fat të keq tash nuk

funksionon, është Sistemi Informativ Shëndetësor. Kryetar, ti e dish se je mjek, Sistemi Informativ Shëndetësor, Pika 2 thotë: Departamenti i SISH-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në koordinim me QKMF-në bën implementimin e Sistemit edhe funksionimin e tij në të gjitha nivelet e institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor. Sistemi Informativ në asnjë institucion nuk punon, kryetar. Këtu ka ngecje. Ka pas SISH – e di mësuesi Behar – tash nuk ka hiç. Keni premtue kështu një kohë të gjatë që do t’i bëni funksionale edhe nëpër QMF, edhe nëpër AMF, po nuk i keni bo. Pres zbatim nga këto. Neni 11, Këshilli Drejtues – struktura. Edhe këtu pres të formohet kjo strukturë, se gjendja është e mjerusehme në QKMF, për fat të keq. Kështu e keni gjet, po mësuesi Behar hala po e vazhdon ma tutje, në të njëjtin avaz. Domethënë, këtu në Këshillin Drejtues duhet të ketë drejtorin e QKMF-së i cili kryeson, udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare, Kryeinfermieri/ja, udhëheqësi i Departamentit të Administratës, Koordinatorin për Cilësinë e Shërbimeve Shëndetësore, përfaqësuesi i Sindikatës, përfaqësuesi nga Këshilli i Pacientëve. Pres nga ju që këto t’i formoni. Neni 12, Kompetencat dhe Detyrat: Pastaj shkojmë te Neni 14, Procedurat e emërimit të drejtorit dhe kryeinfermierit/es. Te drejtori po shkojmë, po më vjen mirë, pasi ta votojmë këtë Statut, duhet me e zbatue, me e zgjedhë drejtorin me konkurs, kryetar, edhe kryeinfermierin/en. Po pres – shumë shpejt edhe me të dy duart kam me e votue. Të shohim mas votimit të kësaj çka do të bëni. Me vazhdue ma shumë, kryetar, mos po na del naj kërcënim, naj diçka, se keni marak, se parëz i thaje edhe Uranit unë i ka marak me i zajeb njerëzit. Po shkojsh po më zajebish edhe mu e s’ka kush më ruan, ma mirë s’po diskutoj shumë, po e ruaj veten pak.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë kryetari i Komunës, bashkë me z.Munir, i patën disa propozime, ndërsa Artan Loshaj deshti që disa nene të funksionojnë, pasi janë të mira edhe për Statutin e QKMF-së. Atëherë, nëse pranon Muniri, nuk po i ndaj veç e veç, por të dyjat po i qesim të përbashkëta, edhe të kryetarit edhe të Munirit po i qes bashkë edhe po e qes në votim këtë Statut. Atëherë, me këto dy propozime nga kryetari dhe z.Muniri. e qesim në votim Statutin e QKMF-së. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet Statuti i QKMF-së në Dragash. Atëherë, e kemi veç pikën eventuale. A po vazhdojmë? Atëherë, po vazhdojmë me pauzë, në ora 13:00 kthehemi në seancë! Faleminderit!

Atëherë, të dashur kolegë, pasi vetë deshët që deri në ora 13:00 me dalë për drekë, edhe në ora 13:00 ka qenë kthimi, ne disa kemi marrë pjesë, disa nuk kanë ardhë në pikën eventuale, atëherë unë me keqardhje po them që, ka qenë shumë mirë që pikën eventuale me i parashtrur kryetarit e drejtorëve pyetje. Por, pasi nuk ka kuorum, e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancën tjetër!

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj